

CEL Kosova dhe Departamenti i Sociologjisë

PËRVOJAT E COMING OUT (DALJES HAPUR) TË INDIVIDËVE LGBT+ NË KONTEKSTIN KOSOVAR

Hulumtuese: Riola Koliqi & Edonita Sadiku
Mentore: Prof. Ass. Linda Gusia



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

HULUMTUESE: RIOLA KOLIQI & EDONITA SADIKU
MENTORE: PROF. ASS. LINDA GUSIA
SHTATOR, 2026

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga SIDA – Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar dhe u realizua në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerit dhe donatorit.

Abstrakti

Ky hulumtim trajton përvojat coming out apo daljes hapur të personave LGBTI+ në kontekstin kosovar gjatë vitet e fundit. Ky hulumtim synon të vë në pah vështirësitë e këtij procesi në një kontekst paragjykues dhe në një frymë antigjinore në rritje. Duke filluar nga rrëfimet personale dhe me anë të analizës së diskursit mediatik, veçanarisht në shqyrtim të Big Brother VIP Kosova edicioni 1, 2, 3. Me qëllim të vënies në pah të përvojave reale dhe sfidave me të cilat ata përballen, si dhe mënyrës se si mediat reflektojnë dhe ndikojnë në perceptimet e shoqërisë.

Fjalë kyçe: LGBTI+, Coming out (dalja hapur), Kosovë, media, përvoja, Big Brother VIP Kosova.

Hyrje

Në Kosovë, pavarësisht disa përparimeve në rritjen e ndërgjegjësimit dhe diskutimit publik, shumë individë ende përballen me vështirësi gjatë këtij procesi, për shkak të frikës nga refuzimi dhe gjykimi nga familja dhe shoqëria. Coming out apo dalja hapur është një proces jetik për personat LGBTI+, pasi që lidhet me pranimin në shoqëri dhe me mundësinë për të qenë vetvetja. Kjo përvojë shpeshherë është edhe ngjarja më traumatike për këta të rinjtë, si pasojë e pritshmërive shoqërore, paragjykimeve të mëdha rreth orientimit seksual dhe heteronormativitetit që mbizotëron në shoqëri. Kështu, ky proces shoqërohet me presion që shfaqet në forma të ndryshme, deri në dhunë. Roli i shoqërisë dhe veçanërisht rrethit të ngushtë dhe familjes është jetik në këtë proces, deri sa mënyrat se si media trajton këto çështje shpesh amplifikon paragjykimet, por edhe mund të ndikojë në ndryshimin e perceptimeve publike dhe në përvojat e tyre personale.

Mediat mund ta luajnë një rol të rëndësishëm në mënyrën se si njerëzit i kuptojnë komunitetet LGBTI+, pasi në shumë raste ofrojnë mundësi për njohjen më të afërt të komunitetit dhe për sfidimin e paragjykimeve. Representimi i këtij grupi krijon hapësirë për përfaqësimin e llojllojshmërisë së përvojave të këtij komuniteti, megjithatë, mund dhe të rrisë paragjykimet. Emisione mjaft të ndjekura, si “Big Brother VIP Kosova”, kanë sjellë në vëmendje tre individë nga komunitetet LGBTI+, edhe pse jo gjithmonë në mënyrë adekuate. Prandaj, është e rëndësishme të krahasohen përvojat reale të individëve me mënyrën se si ato paraqiten në media.

Pyetjet që na kanë udhëhequr gjatë këtij hulumtimi janë: Si përfetojnë individët LGBTI+ procesin e daljes hapur në Kosovë dhe cilat janë sfidat kryesore që hasin gjatë këtij procesi? Cili është roli i familjes dhe i shoqërisë në përvojat e daljes hapur të individëve LGBTI+? Si paraqiten përvojat e daljes hapur të individëve LGBTI+ në media, dhe sa përputhen ose ndryshojnë nga përvojat reale të tyre? Këto pyetje kanë shërbyer si bazë për strukturimin e këtij hulumtimi i cili reflekton përvojat personale dhe coming out në rrethin e ngushtë si dhe përvojat e coming out të individëve LGBTI+ në kontekstin Kosovar në sferën publike dhe në media.

METODOLOGJIA

Në këtë hulumtim përdoret një qasje kualitative, hulumtimi është mbështetur në të dhëna sekondare dhe në analizën e diskursit, kryesisht për arsye etike. Një element thelbësor që ka udhëhequr hulumtimin është respektimi i parimit “Do No Harm” (“Mos shkakto dëm”). Pas shqyrtimit të literaturës dhe diskutimeve me komunitetet LGBTI+, kemi vlerësuar se kjo përvojë ka qenë traumatike për shumicën e personave të përfshirë. Kështu, për të shmangur ri-traumatizimin dhe shqetësimet e panevojshme, ky hulumtim nuk ka realizuar intervista të reja, por është bazuar në dëshmi ekzistuese, të cilat janë bërë publike me pëlqimin e vetë personave. Kjo qasje etike synon të minimizojë rrezikun e shkakut të dëmit, duke garantuar, megjithatë, trajtimin e historive me dinjitet maksimal dhe respektimin e vullnetit të personave për të ndarë përvojat e tyre në publik. Ky hulumtim merr për bazë përvojat e publikuara në platformën e Dylberizmit shërbyer si një ndër burimet për këtë hulumtim.

Metoda bazohet në analizën e intervistave ekzistuese, tregimeve personale të arkivuara dhe raporteve hulumtuese, me qëllim që të krijohet një pamje e gjerë mbi përvojat e daljes hapur në sferën private, në kuptimin që coming out-i nuk ka qenë një ngjarje e bërë publike përmes mediave. Kështu, për të kuptuar se si reflektohet coming out-i në sferën publike dhe në shoqërinë më të gjerë, hulumtimi analizon gjithashtu edhe emisionin Big Brother VIP Kosova. Ky analizim shkon përtej temave të thjeshta, duke shqyrtuar se si media i trajton identitetet LGBTI+ dhe sa ndikojnë mediat në formësimin e paragjykimeve ose në pranimin e këtij identiteti në shoqërinë Kosovare.

Përvojat e Daljes Hapur (Coming Out) të Individëve LGBTI+ në Kontekstin Kosovar

Coming out është procesi përmes të cilit një person vendos të zbulojë orientimin e tij seksual dhe/ose identitetin gjinor. Ky proces mund të përjetohet në forma të ndryshme, si një udhëtim personal, një vendim i vështirë ose një akt çlirimi nga stigma dhe fshehja.

Për personat LGBTI+ frika nga paragjykimet, heteronormativiteti mbizotërues dhe homofobia, ndikojnë drejtpërdrejt në vendimin se kur, si dhe nëse do ta bëjnë coming out-in. Kështu, veçanërisht homofobia ndikon jo vetëm në mënyrën se si individi trajtohet pas daljes hapur, por edhe në vetë procesin e coming out-it. Prandaj, coming out-i është një proces gradual, i kujdesshëm dhe fragjil, i cili fillon nga vetëpranimi në një shoqëri e cila insiston të të shohë si përjashtim, jo si pjesë të natyrshme të diversitetit shoqëror. Homofobia shfaqet me paragjykimet dhe komentet negative deri te diskriminimi, bullizmi dhe dhuna dhe shpesh e dominojnë këtë proces.

Në vitet e fundit, çështjet e gjinisë dhe seksualitetit janë bërë pjesë e debateve shoqërore dhe politike globale. Në këtë kuadër është zhvilluar edhe diskursi antigender, i cili kundërshton ndryshimet në kuptimin e gjinisë, familjes dhe seksualitetit nga një qasje e barazisë dhe drejtësisë. Ky diskurs shpesh lidhet ngushtë me mbrojtjen e familjes tradicionale dhe roleve të caktuara për burrat dhe gratë. Veçanërisht, ai lidhet me heteronormativitetin si normë absolute, duke bërë që identitetet LGBTI+, ato të grave që dalin nga këto norma rigjide patriarkale, si dhe të gjithë të tjerët që sfidojnë këto norma, të përballen me paragjykime dhe diskriminim.

Në Kosovë, këto çështje sidomos ndërlidhen me pritshmëritë tradicionale për familjen, martesën dhe rolet tradicionale gjinore. Insistimi i këtyre grupeve në disiplinimin e këtij rendi, e veçanërisht në heteronormativitetin si normë absolute, e bën coming out-in një proces të nevojshëm, por edhe më të vështirë. Ky hulumtim e njeh këtë tendencë të re globale antigjinore, edhe pse nuk e trajton korelacionin e drejtpërdrejtë të saj në këtë hulumtim.

Përvojat e daljes hapur (coming out) të individëve LGBTI+ në kontekstin Kosovar NË SFERËN PRIVATE

COMING OUT-I NDAJ VETES: PROCESI I VETËKUPTIMIT DHE VETËPRANIMIT

Coming out-i ndaj vetes është një proces i brendshëm, ku personi fillon ta kuptojë dhe ta pranojë se kush është. Ky proces merr trajta të ndryshme, varësisht nga përballja me ndjenjat romantike, identitetin gjinor apo kërkimi i një përkufizimi për përvojat vetjake.

Kjo shihet, për shembull, te rrëfimi i një personi anonim në shkrimet e revistës Dylberizm, i cili, në moshë të re, krijon një shoqëri shumë të afërt me një vajzë. Në fillim, ndjenjat që kishte për të i konsideronte thjesht si simpati. Mirëpo, sa më shumë afrohej me të, aq më shumë e kuptonte se diçka ishte ndryshe. Siç e përshkruan vetë, çdo mesazh dhe çdo fjalë e saj i shkaktonte “fluturat n’bark”. Pikërisht këtu ndodh një moment i rëndësishëm i vetëkuptimit, sepse ajo arrin ta kuptojë se ajo që e kishte quajtur më herët simpati ishte, në fakt, tërheqje romantike. Pas shumë të qarash dhe ballafaqimesh me veten, në moshën 14-vjeçare, ajo arrin ta pranojë veten ashtu siç është. Pra, në këtë rast, vetëpranimi vjen pasi personi fillimisht arrin t’i kuptojë dhe t’i emërtojë ndjenjat e veta. (Dylberizm 2. , 2025)

Ndryshe prej saj, personi i referuar si JB (JB, 2025) e përjeton këtë proces përmes eksplorimit të identitetit gjinor. Që i vogël, ndihej ndryshe prej djemve të tjerë dhe gjente kënaqësi në gjëra që shoqëria i konsideronte “femërore”, por, për shkak të keqtrajtimit, filloi t’i fshihte këto pjesë të vetes. Më vonë, përmes njohjes me persona të tjerë dhe, sidomos, përmes drag-ut, filloi ta shfaqte identitetin më lirshëm. Në fund, kuptoi se nuk ndihej as plotësisht mashkull e as femër, por e gjeti veten te identiteti jobinar. Kështu, te personi i referuar si JB, vetëkuptimi nuk vjen nga një moment i vetëm, por nga një rrugëtim i gjatë, ku ai fillon t’u japë kuptim ndjenjave dhe përvojave që, si fëmijë, i kishte ndier, por i kishte fshehur.

Historia e Blert Morinës lidhet me kuptimin gradual të identitetit trans dhe me dëshirën për ta jetuar veten në përputhje me atë që ndiente. Një moment që e tregon këtë është kur ai thotë se “Tranzicioni atëherë s’kish qenë as opsion”, duke treguar se e kishte të vështirë ta imagjinonte një të ardhme ku mund të jetonte plotësisht në përputhje me identitetin e tij. Më vonë, gjatë studimeve, përmes njohjes me komunitetin queer dhe angazhimit në CEL, ai filloi ta kuptonte më qartë veten dhe mundësitë që kishte. (Dylberizm 2. , 2025)

Këto tri rrëfime tregojnë se coming out-i, sidomos ndaj vetes, nuk ka një rrugë të vetme. Për dikë, ai nis me një ndjenjë dashurie që më në fund merr emër; për dikë tjetër, me pyetjen “Kush jam unë?” dhe me eksplorimin e gjinisë; ndërsa për dikë tjetër, me nevojën për ta kuptuar veten përtej roleve që shoqëria ia ka caktuar. Megjithatë, të tria rastet tregojnë se vetëpranimi është një proces gradual, i cili mund të ndodhë para se personi të jetë gati t’ua tregojë identitetin e tij të tjerëve. Kjo nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht se rrugëtimi i mëtejshëm do të jetë i lehtë. Përkundrazi, pasi individ fillon ta shfaqë identitetin e tij në jetën e përditshme, ai mund të përballë me diskriminim, bullizëm dhe pasoja në mirëqenien personale.

Përvoja e Arlinda Morinës e ilustron këtë, pasi ajo ka përjetuar diskriminim, homofobi dhe bullizim në Fakultetin e Arteve dhe gjatë audicioneve, ku shprehja e saj gjinore ka ndikuar edhe në mundësitë për role dhe në zhvillimin e karrierës. Këto përvoja kanë ndikuar edhe në mirëqenien e saj emocionale, duke çuar në depresion dhe abuzim me substanca (Dylberizm 2. , 2024). Ky rast tregon se procesi i pranimi të vetes mund të pasohet nga sfida të tjera, sidomos kur identiteti i personit përballë me paragjykime dhe diskriminim në shoqëri.

OUTING-U: MES HUMBJES SË KONTROLLIT, EKSPOZIMIT DHE PASOJAVE

Përveç coming out-it, një përvojë tjetër që lidhet me zbulimin e identitetit seksual ose gjinor është edhe outing u. Ndryshe nga coming out-i, ku personi vetë vendos se kur, si dhe kujt dëshiron t'ia tregojë identitetin e tij, outing-u ndodh kur dikush tjetër e bën këtë identitet publik pa pëlqimin e personit. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndë, sepse personi e humb kontrollin mbi një pjesë shumë personale të jetës së tij dhe mund të përballë me pasoja që nuk ka qenë i gatshëm t'i përjetojë. Një shembull i tillë është rasti i Igballë Rogovës, e cila tregon se pasi lidhja e saj me një grua u bë publike pa pëlqimin e saj. Si pasojë e këtij ekspozimi të padëshiruar, ajo u përball sulme mediatike, kërcënime dhe ngacmime publike (Dylberizm 2. , 2023). Ky rast tregon se outing-u nuk është thjesht një zbulim i një informacioni personal, por mund të ketë pasoja serioze në jetën private, në marrëdhëniet me të tjerët dhe në sigurinë e personit.

COMING OUT-I NDAJ FAMILJES: MES FSHEHJES, FRIKËS DHE PRANIMIT

Pas vetëkuptimit dhe vetëpranimit, një nga hapat më të vështirë mund të jetë përballja me familjen dhe rrethin e ngushtë. Në shoqërinë tonë, familja shpesh funksionon si një rreth që kërkon që çdo anëtar t'u përshtatet rregullave të “normales” ose asaj që quhet heteronormativitet. Kjo shpesh nënkupton, sidomos, përshtatjen strikte me rolet gjinore tradicionale dhe modelin heteronormativ të martesës. Sipas Studimit për Rininë në Kosovë të Friedrich Ebert Stiftung, shumica e të rinjve në Kosovë vazhdojnë ta konsiderojnë familjen si institucionin më të rëndësishëm shoqëror, ndërsa martesën tradicionale si modelin dominues të jetës familjare. (Rrumbullaku, 2019).

Përvojat e Malit tregojnë se ky presion mund të ndihet që në fëmijëri, shumë kohë para se personi ta kuptojë plotësisht identitetin e vet. Ai thotë: “Gjithmonë e ndieja që mënyra se si ata më shihnin dhe më kategorizonin ishte në kundërshtim të plotë me atë se si unë e përjetoja veten.” Konflikti me pritshmëritë familjare mund të ekzistojë edhe para coming out-it, kur personi ndien se nuk përputhet me këto pritshmëri dhe zgjedh heshtjen si metodë përballjeje, apo edhe jetën e dyfishtë. (Dylberizm 2. , 2024).

Po ashtu, për personin e referuar si JB, ky presion çon drejt fshehjes si një formë mbijetese. Ai tregon: “Për vite me radhë kisha fshehur çdo pjesë të identitetit tim që nuk përputhej me pritshmëritë e prindërve. Çdo lëvizje e bëja me frikën se mos po zbulojnë diçka që do ta prishte balancën në shtëpi.” (JB, 2025). Heshtja nuk pasqyron mungesë të vetëpranimit, por një strategji mbijetese për të ruajtur balancën familjare.

Por, kur heshtja thyhet, mund të ndodhin edhe ndryshime të papritura. Momenti kur nëna e këtij personi e pranon atë tregon se dashuria dhe lidhja familjare mund të jenë më të forta se paragjykimet dhe pritshmëritë e ngurta. Ajo i thotë: “Unë të dua, qofsh vajzë apo djalë, ti je fëmija im.” Pranimi nga familja nuk varet domosdoshmërisht nga njohuritë e thelluara për çështjet LGBTI+, por edhe nga gatishmëria për të dëgjuar, për të kuptuar dhe për ta pranuar të afërmin.

Kjo shihet qartë edhe në përvojën e Lendit, i cili e përshkruan mbështetjen që mori nga familja si diçka që ia lehtësoi shumë procesin e gjetjes së vetes. Ai shprehet: “Në krahasim qysh e kom prit, këtë përkrahje s'di a kish mujt me marrë dikush qysh e kom marrë unë, edhe njihna shumë i privilegjum. Reagimet që i kom marrë unë herën e parë ma kanë lehtësu shumë procesin qysh unë me gjet veten.” Lendi tregon se fillimisht i ishte frikësuar një reagimi negativ nga familja, si “jo a je normal”, “qa je tu bo kështu” apo “duhesh me ndryshu”, por reagimi i motrës së tij ishte thjesht: “Okej, je je”, ndërsa nëna i tha: “Mos u mërzi ti se krejt zgjidhen.”

Edhe pse, siç thekson Lendi, familjarët e tij, veçanërisht nëna “nashta s’kanë pas” shumë informacione për komunitetet LGBTI+, ai thotë se ajo “ka tentu me u informu sa ka mujt që me ma ofru mu ni jetë ma t’lumtur”. Për Lendin, mbështetja e familjes nuk erdhi nga njohuritë e tyre të mëdha për çështjet LGBT+, por nga “dëshira” dhe “vullneti me m’pranu”. Për këtë arsye, ai e konsideron veten “shumë të privilegjum” për mbështetjen që ka marrë, duke pranuar se, fatkeqësisht, jo të gjithë personat LGBTI+ e kanë të njëjtën përvojë. (Mustafa, 2021)

Megjithatë, jo çdo zbulim i orientimit seksual brenda familjes përfundon me pranim apo mirëkuptim. Albi tregon rastin e një shoqeje të tij lezbike, e cila kishte qenë në një lidhje me një vajzë. Pasi familja e të dashurës së saj e zbuloi lidhjen, vëllezërit e vajzës përdorën dhunë fizike ndaj saj dhe i thanë të qëndronte larg të dashurës. Sipas rrëfimit të Albit, ata e tërhoqën për flokësh dhe e goditën me grushte, derisa ajo arriti të largohej. Ky rast tregon se zbulimi i një marrëdhënieje queer brenda një familjeje jo-pranuese mund të ketë pasoja të rënda, duke përfshirë dhunën fizike dhe kërcënimet ndaj sigurisë së personit. (Davies, 2017)

Këto përvoja tregojnë se reagimi i familjes ndaj coming out-it mund të jetë shumë i ndryshëm, nga pranimi dhe mbështetja deri te mospranimi, dhuna dhe kërcënimet. Pikërisht këtë dimension e thekson edhe Igballë Rogova, e cila e përshkruan coming out-in ndaj familjes si një përballje jo vetëm me frikën e individit, por edhe me frikën dhe paragjykimet e familjes: “Coming out ndaj familjes ishte përballje me frikën time, por edhe me frikën e tyre. Duhej t’i çliroja ata nga paragjykimet, po aq sa duhej ta çliroja veten.” (Dylberizm 2. , 2023). Në këtë kuptim, coming out-i ndaj familjes mund të shihet si një proces ku jo vetëm individ përpigjet të çlirohet nga frika e fshehjes, por edhe familja përballlet me paragjykimet dhe bindjet që mund t’i ketë pasur më herët.

Megjithatë, ky proces shpesh ndërlikohet nga presioni i ambientit të jashtëm, veçanërisht në qytetet më të vogla, ku reputacioni familjar mbart një peshë të madhe sociale. Albi, një student nga Gjilani, që e jeton këtë realitet, shpjegon se frika e prindërve shpesh nuk lidhet drejtpërdrejt me identitetin e fëmijës, por me frikën nga opinioni i të tjerëve: “Besoj se shumica e prindërve shqiptarë do ta pranonin fëmijën e tyre, por shqetësohen për atë që mendojnë dhe thonë të tjerët”. Për të, “fshehja” shpesh bëhet një marrëveshje e heshtur për të ruajtur qetësinë në shtëpi, ku individ mund të zgjedhë të mos e bëjë të dukshëm identitetin e tij, ndërsa familja mund të përpigjet ta mbajë atë të fshehtë nga të tjerët. Kjo shihet edhe në rrëfimin e Albit, i cili shprehet se ka frikë se, nëse do t’i tregonte babait për seksualitetin e tij, thotë: “ose do të më braktisin, ose do të përpigjen ta mbajnë të fshehtë nga të tjerët.” (Davies, 2017). Kjo tregon se fshehja mund të shërbejë si një mënyrë për të shmangur konfliktin dhe për të ruajtur qetësinë brenda familjes, sidomos kur ekziston frika nga thashethemet dhe gjykimi i rrethit shoqëror.

Në fund, këto dëshmi tregojnë se familja nuk është gjithmonë e pandryshueshme. Ajo mund të jetë vendi ku paragjykimet krijojnë frikë dhe heshtje, por mund të bëhet edhe një hapësirë pranimi, nëse individ gjen guximin të flasë dhe familja ka gatishmërinë të dëgjojë.

COMING OUT-I NDAJ RRETHIT SHOQËROR: MIQTË, KOLEGËT DHE MARRËDHËNIET E AFËRTA

Ndryshe nga familja, miqtë dhe kolegët janë marrëdhënie që individi mund t'i zgjedhë vetë, ndaj miqtë mund të bëhen një lloj “familje e zgjedhur”. Megjithatë, coming out-i ndaj tyre nuk është gjithmonë i lehtë. Pranimi nga miqtë krijon siguri dhe e ndihmon individin ta jetojë identitetin e tij pa fshehje.

Për individë në profesione publike, si Arbër Selmani, coming out është sfidues. Ai thotë: “Ndihesha sikur çdo hap i imi në punë analizohej përmes orientimit tim seksual. Ishte një negociatë e vazhdueshme mes asaj që isha unë dhe asaj që prisnin kolegët të shihnin.” (Dylberizm 2. , 2024). Kjo tregon se, në ambientin profesional, coming out-i nuk lidhet vetëm me momentin e shfaqjes së identitetit, por edhe me frikën nga trajtimi i mëvonshëm, si dhe me paragjykimet, kornizimin dhe reduktimin e individit vetëm në orientimin e tij seksual.

Megjithatë, shumë individë gjejnë mënyra për ta lehtësuar këtë proces. Stephany Candela tregon se ka arritur të ndryshojë këndvështrimin e të tjerëve përmes dialogut: “Thjesht u tregon një histori që i vendos në këpucët e tua, e ngroh bisedën ngadalë dhe, në një moment të caktuar, u tregon të vërtetën” (Davies, 2017). Për të, kjo nuk është një “shpërthim”, por një proces i ngadaltë që i ndihmon të tjerët ta shohin njeriun përtej etiketimeve, duke e bërë coming out-in më pak të frikshëm.

Përkrahja e njerëzve të afërt mund ta bëjë këtë proces më të lehtë. Kjo shihet edhe te përvoja e Lendit, i cili tregon se, pasi doli hapur për identitetin e tij gjinor, u ndje i çliruar nga pritshmëritë që të tjerët mund të kishin ndaj tij. Ai e përshkruan këtë ndjenjë duke thënë se më në fund mund të ishte “100% vetvetja”, pa pasur më nevojë të përmbushte pritshmëritë e të tjerëve. (Mustafa, 2025). Kjo dëshmon se pranimi nga rrethi shoqëror nuk është thjesht njohje e identitetit, por edhe krijimi i një hapësire ku individi mund ta jetojë atë pa vetëcensurë.

Përvojat e coming out në hapësirën publike, megjithatë, nuk janë gjithmonë pozitive. Rasti i Lend Mustafës tregon se, pavarësisht përvojës pozitive dhe mbështetjes që kishte marrë nga familja, coming out-i i tij si pjesë e komuniteteve LGBTI+ në hapësirën publike mund të shoqërohet edhe me pasoja serioze për sigurinë personale. Pas coming out dhe ekspozimit të identitetit të tij, ai u përball me sulme dhe kërcënime publike, duke treguar se shfaqja publike e identitetit të tij mund ta ekspozojë individin ndaj rreziqeve që shkojnë përtej paragjykimeve dhe komenteve negative, deri te kërcënimet dhe dhuna. (Mustafa, 2021). Ky rast paraqet një dimension tjetër të coming out-it në hapësirën publike: ndërsa coming out mund të sjellë çlirim dhe mundësi për ta jetuar veten pa fshehje, njëkohësisht ajo mund të shoqërohet me frikë, pasiguri dhe rrezik për sigurinë personale.

NGA INDIVIDI TE KOMUNITETI: GJETJA E PËRKATËSISË DHE HAPËSIRAVE TË SIGURTA

Coming out-i mund të fillojë si një proces personal, por me kalimin e kohës, individi kupton se nuk është i vetëm në përvojat e tij. Komuniteti bëhet thelbësor, pasi u mundëson personave LGBTI+ të ndajnë përvoja të ngjashme pa pasur nevojë ta maskojnë identitetin e tyre.

Kjo shihet në historitë e Qerkicës dhe Mustafës, të cilët, në fillimet e aktivizmit queer në Kosovë, krijuan një hapësirë ku njerëzit mund të takoheshin dhe të flisnin më lirshëm për përvojat e tyre. Shtëpia e tyre në Prishtinë u bë një strehë ku njerëzit mblidheshin larg gjyqimit shoqëror për të ndarë përvojat e tyre. Në një shoqëri ku mungonin hapësirat e sigurta, fakti që dikush kishte një derë ku mund të hynte pa frikën se do të gjykohej, kishte një rëndësi të veçantë. (Dylberizm 2. , 2023)

Hapësira e sigurt nuk është vetëm një vend fizik, por edhe një hapësirë ku personi ndihet se nuk duhet të luajë një rol ose të fshehë pjesë të vetes. Për këdo që është ndier i vetmuar, takimi me persona me përvoja të ngjashme shënon një moment të rëndësishëm përkatësie.

Myrvete Bajrami e çoi këtë nismë një hap më tej, duke e kthyer këtë nevojë personale në një kauzë publike. Në fillimet e aktivizmit queer në Kosovë, ajo tregon se njerëzit takoheshin në vende të fshehta, ku mund të flisnin për përvojat e tyre dhe të dëgjonin njëri-tjetrin pa frikën se do të ekspozoheshin. Këto takime krijojnë një ndjenjë përkatësie që kishte munguar më parë. Nga aty, përvojat që fillimisht dukeshin individuale filluan të shiheshin si probleme të përbashkëta, duke krijuar nevojën për organizim dhe për një zë më të fuqishëm në shoqëri. (Dylberizm 2. , 2023)

Më vonë, kjo nevojë për hapësira të sigurta mori forma të ndryshme, përmes vendeve si Bubble dhe hapësirave të tjera ku personat queer mund të takoheshin dhe të shoqëroheshin (Dylberizm, 2023). Siç thekson Arlinda Morina, “për mirë është fakti që kemi një vend si Bubble ku mundemi m’u mbledhë bashkë e me konë vetja”. Këto hapësira janë të rëndësishme në një kontekst ku homofobia dhe paragjykimet mund t’i bëjnë personat e komuniteteve LGBTI+ të ndihen të pasigurt ose të detyruar ta fshehin identitetin e tyre. Përveç socializimit, ato krijojnë lidhje, mbështetje dhe ndjenjë përkatësie. (Dylberizm 2. , 2024)

Prandaj, rrugëtimi nga individi te komuniteti tregon se coming out-i nuk përfundon me pranimin vetjak apo me shfaqjen e identitetit. Për shumë persona, hapi tjetër është gjetja e një vendi ku ndihen se i përkasin.

Përvojat e daljes hapur (coming out) të individëve LGBTI+ në kontekstin Kosovar **SFERËN PUBLIKE DHE NË MEDIA**

Coming out është një proces që nuk zhvillohet vetëm në marrëdhëniet personale dhe familjare, por mund të marrë një dimension tjetër kur identiteti i individit bëhet pjesë e hapësirës publike. Në këtë rast, përvoja personale nuk mbetet më vetëm në nivel individual, por bëhet pjesë e diskutimeve, reagimeve dhe interpretimeve të shoqërisë.

Në Kosovë, media ka një rol të rëndësishëm në mënyrën se si këto përvoja paraqiten dhe kuptohen nga publiku. Përmes programeve televizive dhe rrjeteve sociale, individët LGBTI+ mund të fitojnë më shumë dukshmëri, por njëkohësisht mund të përballen edhe me paragjykime, stigmatizim dhe interpretime të ndryshme të identitetit të tyre. Në këtë kuadër, Big Brother VIP Kosova përbën një hapësirë të rëndësishme për të analizuar se si përvojat e coming out-it kalojnë nga sfera personale në atë publike dhe se si media dhe publiku reagojnë ndaj tyre.

Në këtë pjesë analizohen rastet e Big Brother 1 Edon Shilekut, 2 Edona James dhe 3 Vullnet Krasniqit, duke u fokusuar në mënyrën se si identitetet dhe përvojat e tyre janë paraqitur në media dhe janë pritur nga publiku. Përmes këtyre rasteve synohet të kuptohet më mirë ndërveprimi mes përvojës personale të coming out-it, përfaqësimit mediatik dhe perceptimeve shoqërore në kontekstin kosovar.

RASTI I EDONA JAMES

Një nga rastet më të diskutuara në hapësirën publike kosovare është rasti i Edona James, e cila përmes pjesëmarrjes në “Big Brother VIP Kosova 2” u bë një nga figurat më të dukshme transgjimore në televizionin kosovar. Prania e saj në një format televiziv me audiencë të madhe bëri që identiteti transgjimor të diskutohej më shumë në media dhe në rrjetet sociale. Megjithatë, kjo dukshmëri nuk u shoqërua gjithmonë me një trajtim pozitiv dhe të respektueshëm. Në shumë raste, përvoja e Edonës u shoqërua me diskutime rreth identitetit të saj gjimor, mënyrës se si duhej të identifikohet dhe mënyrës se si publiku duhej ta kuptonte atë.

Një nga aspektet më të rëndësishme në rastin e Edonës ishte mënyra se si përdorej gjuha për t’iu referuar identitetit të saj. Gjatë javëve të para të “Big Brother VIP Kosova”, në media, në rrjetet sociale, por edhe në diskutimet brenda shtëpisë, kishte raste kur për të përdorej përemri “ajo”, ndërsa në raste të tjera “ai”. Kjo paqartësi nuk mund të shihet vetëm si një gabim i zakonshëm gjuhësor, pasi tregon edhe vështirësinë që një pjesë e shoqërisë kishte në pranimin dhe kuptimin e identiteteve transgjimore. Përdorimi i përemrit të gabuar mund të ndikojë në mënyrën se si një person perceptohet dhe mund të tregojë mungesë respekti ndaj mënyrës se si individi e përcakton veten.

Nga këndvështrimi i analizës kritike të diskursit, gjuha nuk shërben vetëm për të përshkruar realitetin, por edhe ndikon në mënyrën se si ai kuptohet. Studiuesi Fairclough argumenton se gjuha është pjesë e mënyrës përmes së cilës ndërtohen marrëdhëniet shoqërore dhe identitetet. (Fairclough, 1995). Në këtë rast, kur një grua trans identifikohet vazhdimisht me përemra mashkullorë, kjo mund të shihet si një mënyrë për të mos e pranuar plotësisht identitetin e saj gjimor. Pra, mënyra e përdorimit të gjuhës tregon se si normat tradicionale gjimor vazhdojnë të ndikojnë në mënyrën se si shoqëria i kupton dhe i pranon personat transgjimorë.

Një tjetër çështje që u shfaq në diskutimet rreth Edona James ishte përdorimi i emrit të saj të mëparshëm. Kjo praktikë njihet si deadnaming dhe konsiderohet problematike, pasi përdor një emër me të cilin personi nuk identifikohet më. Në këtë mënyrë, vëmendja kthehet te identiteti i mëparshëm i individit dhe jo te identiteti me të cilin ai person zgjedh të jetojë dhe të prezantohet.

Kjo mund të lidhet edhe me idetë e Foucault, i cili argumenton se pushteti nuk ushtrohet vetëm përmes institucioneve, por edhe përmes diskurseve dhe mënyrave të të folurit që përcaktojnë se çfarë konsiderohet normale dhe çfarë jo. (Foucault, 1978). Në rastin e Edonës, përdorimi i vazhdueshëm i emrit të mëparshëm ose i përemrave mashkullorë mund të kuptohet si një mënyrë për ta kundërshtuar identitetin që ajo ka zgjedhur për veten. Përmes gjuhës, një pjesë e publikut përpigëj ta lidhte atë përsëri me identitetin e saj të mëparshëm, duke mos e respektuar plotësisht të drejtën e saj për vetëpërcaktim.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është mënyra se si mediat zgjedhën ta prezantonin Edonën. Në disa raste, titujt mediatikë e vendosnin identitetin e saj trans në qendër, duke përdorur formulime si “transgjinorja Edona James” ose “banorja trans”. Kjo bëri që identiteti gjinor të bëhej shpesh karakteristika kryesore dhe spektakel përmes së cilës ajo prezantohej para publikut. Sipas Hall, media nuk e pasqyron realitetin në mënyrë neutrale, por përmes mënyrës se si zgjedh të paraqesë njerëzit dhe ngjarjet krijon kuptime të caktuara. (Hall, 1997). Në këtë kuptim, mënyra se si Edona përfaqësohej në media ndikonte edhe në mënyrën se si publiku e kuptonte atë.

Kur identiteti trans vendoset vazhdimisht në qendër, banalizohet dehumanizohet dhe ekziston rreziku që individi të reduktohet vetëm në një pjesë të identitetit të tij. Megjithatë, rasti i Edonës nuk duhet parë vetëm në aspektin negativ. Prania e saj në televizion u dha mundësi shumë njerëzve ta njihnin atë përtej stereotipeve që ekzistojnë për personat transgjinorë. Përmes paraqitjes së saj, publiku pati mundësi ta njihnte për humorin, sinqeritetin dhe spontanitetin e saj dhe deri diku ta sheh edhe njerzoren, perkunder kornizes se spektaklit ne kete format televiziv. Në këtë kuptim, rasti i Edona James me shume se te tjeret tregon se dukshmëria publike mund të ketë dy anë. Nga njëra anë, ajo mund të ndihmojë në familjaritet me identiteteve transgjinore, ndërsa nga ana tjetër mund të sjellë stigmatizim, egzagjerim dhe vëmendje të tepruar ndaj identitetit gjinor. Kjo përvojë tregon se coming out nuk përfundon vetëm në momentin kur individi e shpreh identitetin e tij, por vazhdon edhe më pas, përmes mënyrës se si shoqëria dhe media e pranojnë dhe e interpretojnë atë identitet.

RASTI I VULLNET KRASNIQIT

Një tjetër rast i rëndësishëm i daljes hapur në hapësirën publike kosovare është ai i Vullnet Krasniqit, i cili gjatë pjesëmarrjes në “Big Brother VIP Kosova 3” foli publikisht për orientimin e tij seksual. Rasti i tij ishte i rëndësishëm për shkak se deklarimi u bë në një format televiziv me audiencë të madhe dhe jo në një intervistë të planifikuar ose në një aktivitet të veçantë për të drejtat e komuniteteve LGBTI+. Për këtë arsye, përvoja personale e Vullnetit u shndërrua në një temë që u diskutua gjerësisht në media dhe në rrjetet sociale. Gjatë rrëfimit të tij, Vullnet Krasniqi foli për vështirësitë që kishte përjetuar gjatë adoleshencës dhe për frikën nga mospranimi. Ai tregoi se për një kohë të gjatë ishte përpjekur t'u përshtatej pritshmërive të shoqërisë dhe se në mjedisin ku ishte rritur, homoseksualiteti shpesh trajtohej si diçka e papranueshme. Diskutimi i tij tregoi se procesi i coming out-it mund të jetë i lidhur ngushtë me frikën nga reagimi i të tjerëve dhe me presionin për t'iu përshtatur normave heteronormative.

Nga perspektiva sociologjike, ky rast mund të lidhet me teorinë e Cass, e cila e sheh formimin e identitetit homoseksual si një proces që zhvillohet në disa faza dhe jo si një ngjarje të vetme. (Cass V. C., 1979). Në këtë kuptim, deklarimi publik i Vullnetit nuk mund të shihet si fundi i procesit të coming out-it, por si një fazë e re në të cilën identiteti i tij u bë i njohur për një numër të madh njerëzish. Pas këtij momenti, ai u përball edhe me reagimet e publikut, komentet në rrjete sociale dhe diskutimet mediatike.

Mediat e trajtuan deklarin e Vullnetit në mënyra të ndryshme. Shumë portale e vendosën këtë ngjarje në titujt kryesorë, duke përdorur formulime si “Gazetari pranoi se është gay” ose “Vullnet Krasniqi flet hapur për orientimin seksual”. Në aspektin informues, këto tituj e njoftojnë publikun për një ngjarje të rëndësishme, por njëkohësisht tregojnë edhe mënyrën se si seksualiteti i tij u bë pjesë kryesore e identitetit të tij publik. Në vend që të fokusohet vetëm te profesioni ose puna e tij, vëmendja u përqendrua te orientimi seksual e cila vazhdon të percjellë punën e tij në gazetari hulumtuese, ku komentet denigruese janë pjesë e vazhdueshme e punës së tij.

Kjo mund të lidhet me teorinë e përfaqësimit të Hall, sipas së cilës media nuk pasqyron vetëm atë që ndodh, por përmes gjuhës dhe mënyrës së raportimit ndërton edhe mënyrën se si publiku e kupton një person ose një ngjarje. (Hall, 1997). Në rastin e Vullnetit, mënyra se si mediat e paraqitën deklarin e tij ndikoi në krijimin e një diskutimi të gjerë mbi homoseksualitetin dhe pranimin e diskriminimit të personave LGBTI+ në Kosovë.

Reagimet e publikut ndaj deklarin të tij ishin të ndryshme. Një pjesë e konsiderueshme e njerëzve e mbështetën dhe e vlerësuan guximin e tij për të folur hapur. Për disa persona, deklarimi i tij u pa si një hap i rëndësishëm për rritjen e dukshmërisë së komuniteteve LGBTI+ në Kosovë. Vetë Vullnet Krasniqi, pas përfundimit të emisionit, deklaroi se nuk mendonte se kishte humbur vota ose fansa për shkak të rrëfimit të tij për orientimin seksual.

Megjithatë, krahas mbështetjes pati edhe reagime negative që deshmon për rritjen e diskursit antigjinor sidomos në skenën e artit dhe performancës. Reagimi i reperit Arkimed Lushaj, i njohur si Stresi, i cili e paraqiti dukshmërinë e komuniteteve LGBTI+ si një kërcënim ndaj moralit shoqëror dhe familjar, deshmon për diskurse të ndryshme paralele. Nga perspektiva e analizës kritike të diskursit, kjo mënyrë e të folurit e zhvendos çështjen nga një përvojë individuale në një problem që i atribuohet të gjitha komuniteteve LGBTI+. Pra, orientimi seksual i një individi nuk trajtohet më si pjesë e jetës së tij personale, por përdoret për të folur për një grup të tërë. Përdorimi i fjalëve si “moral”, “familja” dhe “tradita” i jep këtij diskursi një kuptim më të gjerë dhe mund ta bëjë paragjykimin të duket si mbrojtje e vlerave shoqërore.

Diskurset diskriminuese shpesh paraqiten në forma të tilla që përjashtimi të duket i arsyeshëm ose i pranueshëm, thekson Dijk. (Dijk, 1997). Në këto raste, mund të vërehet stigmatizimi, në kuptimin që një karakteristikë e vetme e individit bëhet aq e rëndësishme sa që mbulon pjesët e tjera të identitetit të tij. Goffman e shpjegon stigmën si një proces përmes të cilit një individ zhvlerësohet në sytë e shoqërisë për shkak të një karakteristike që konsiderohet e ndryshme nga normat dominuese. (Goffman E., 1963). Në rastin e Vullnetit, orientimi seksual u bë tema kryesore e diskutimit, ndërsa puna dhe identiteti i tij si gazetar shpesh mbetën në plan të dytë. Rasti i tij tregon se coming out mund të sjellë njëkohësisht mbështetje dhe kundërshtim. Edhe pse deklarimi i tij rriti dukshmërinë e komunitetit LGBTI+ në Kosovë, reagimet treguan se paragjykimet dhe normat tradicionale vazhdojnë të ndikojnë në perceptimin e këtyre identiteteve.

RASTI I EDON SHILEKUT

Edoni është përfaqësuesi i parë i komuniteteve LGBTI+, në edicionin e parë të Big Brother VIP Kosova. Ndryshe nga Edona James dhe Vullnet Krasniqi, vëmendja nuk u përqendrua vetëm te orientimi seksual, por edhe te performanca e tij artistike si drag queen përmes personazhit Victoria Owns. Për shumë shikues, kjo ishte hera e parë që ndesheshin me kulturën drag në një program me audiencë të gjerë, çka krijoi diskutime, por edhe shumë paqartësi.

Që në fillim të emisionit, një pjesë e publikut dhe e mediave e identifikuan gabimisht Edonin si grua transgjimore. Ky konfuzion tregoi mungesën e njohurive për dallimin ndërmjet identitetit gjinor, orientimit seksual dhe performancës drag. Në shumë komente dhe raportime, termat "drag queen", "transgjinor" dhe "homoseksual" u përdorën si sinonime, edhe pse ato përfaqësojnë koncepte të ndryshme. Nga perspektiva e përfaqësimit mediatik, Hall argumenton se media nuk pasqyron vetëm realitetin, por ndërton kuptime shoqërore. (Hall, 1997). Në këtë rast, mungesa e dallimeve të qarta kontribuoi në përforcimin e stereotipeve dhe keqkuptimeve rreth komuniteteve LGBTI+.

Një moment i rëndësishëm ishte deklarimi i Edonit se është biseksual. Ai e prezantoi këtë si pjesë normale të identitetit të tij, pa e kthyer në element dramatik apo në një rrëfim viktimizues. Kjo e dalloi rastin e tij nga narrativat tradicionale të coming out-it, të cilat shpesh ndërtohen rreth frikës dhe vuajtjes. Përkundrazi, orientimi seksual u paraqit si vetëm një aspekt i jetës së tij dhe jo si elementi që e përkufizon tërësisht. Pas përfundimit të emisionit, Edoni ka treguar se personazhi Victoria Owns e kishte ndihmuar të përballej me përvoja të vështira të fëmijërisë dhe njëkohësisht i kishte krijuar mundësinë të fliste për tema që rrallë diskutohen në Kosovë. Në këtë mënyrë, drag-u nuk u paraqit vetëm si formë argëtimi, por edhe si një mjet artistik për të sfiduar stereotipet dhe për të hapur debat mbi identitetin, shprehjen gjinore dhe pranimin shoqëror.

Përfundim

Ky hulumtim tregon se procesi i coming out (daljes hapur) për individët LGBTI+ në Kosovë nuk është një moment i vetëm, por një proces që zhvillohet gradualisht. Ai fillon me kuptimin dhe pranimin e vetes dhe vazhdon me përballjen me familjen, shoqërinë dhe komunitetin. Përvojat e analizuar tregojnë se frika nga refuzimi, paragjykimet dhe pritshmëritë shoqërore ndikojnë shumë në mënyrën se si individët e përjetojnë këtë proces.

Në sferën private, familja mund të jetë një burim i frikës dhe presionit, por në të njëjtën kohë edhe një hapësirë e rëndësishme pranimi dhe mbështetjeje. Përveç familjes, edhe miqtë, komuniteti dhe hapësirat e sigurta kanë një rol të rëndësishëm, sepse i ndihmojnë individët të ndihen më pak të vetëm dhe ta jetojnë identitetin e tyre me më shumë siguri.

Nga ana tjetër, analiza e mediave, veçanërisht e “Big Brother VIP Kosova”, tregon se përfaqësimi i personave LGBTI+ mund të ndikojë në mënyrën se si shoqëria i kupton këto përvoja. Dukshmëria në media mund të ndihmojë në hapjen e diskutimeve dhe në rritjen e pranimin, por mënyra se si këto histori paraqiten mund të ndikojë edhe në krijimin e paragjyimeve ose në trajtimin e identitetit si spektakël.

Në përgjithësi, hulumtimi e mbështet hipotezën se coming out-i në Kosovë ndikohet nga normat shoqërore, familja dhe rrethi përreth. Megjithatë, përvojat e analizuar tregojnë se pranimi, mbështetja dhe komuniteti mund ta bëjnë këtë proces më të lehtë dhe t’i ndihmojnë individët të jetojnë më lirshëm dhe më pranë identitetit të tyre. Diskursi mediatik në Big Brother VIP Kosova, megjithëse shpesh i ndërtuar mbi logjikën e spektaklit dhe sensacionalizimit, krijoi një hapësirë për rritjen e dukshmërisë së komunitetit LGBTI+ dhe njohjen e publikut me përvojat e tij në kontekstin kosovar.

Referenca

Ahmed, S. (2004). The cultural politics of emotion. Edinburgh University Press.

Aktivisti Lendi Mustafa sulmohet dhe kërcënohet publikisht. (2023, Nëntor 8). Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2023/11/08/aktivisti-lendi-mustafa-sulmohet-dhe-kercenohet-publikisht/>

Altman, D. (1971). Homosexual: Oppression and liberation. Outerbridge & Dienstfrey.

Bakija, J. (2025). Edukimi, punësimi dhe diskriminimi ndaj personave LGBTI në Kosovë. CEL.

Bourdieu, P. (2001). Masculine domination. Stanford University Press.

Butler, J. (1988). Performative acts and gender constitution: An essay in phenomenology and feminist theory. Theatre Journal, 519-531.

Cass, V. (1979). Homosexual identity formation: A theoretical model. Journal of Homosexuality, 219–235.

Cass, V. C. (1979). Homosexual Identity Formation: A Theoretical Model. Journal of Homosexuality.

Cass, V. C. (1979). Homosexual identity formation: A theoretical model. Journal of Homosexuality,.

CEL. (2024). Përvojat e të qenit një i ri queer në Kosovë: Vështirësitë dhe shpresat. CEL.

Coleman, E. (1982). Developmental stages of the coming out process. Journal of Homosexuality, 31-43.

Connell, R. (2005). Masculinities. University of California Press.

Crenshaw, K. (1989). Demarginalizing the intersection of race and sex: A black feminist critique of antidiscrimination doctrine, feminist theory, and antiracist politics. University of Chicago Legal Forum, 139-167.

Davies, J. (2017, Tetor 10). "Mum, Dad, I'm...". Retrieved from Kosovo 2.0: <https://kosovotwopointzero.com/en/mum-dad-im>

Dijk, V. (1997). Elite Discourse and Racism. Sage.

Duggan, L. (2003). The new homonormativity: The sexual politics of neoliberalism. In The twilight of equality? Neoliberalism, cultural politics, and the attack on democracy (pp. 50-66). Beacon Press.

Dylberizm. (2023, Prill 15). Shpia e dylberave në Prishtinë, Bubble Pub, mbush 1 vjet. Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2023/04/15/bp-2/>

Dylberizm, 2. (2023, Nëntor 3). Aktivizmi queer në Kosovën e pasluftës nga perspektiva e aktivistes lezbike Myrvete Bajrami. Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2023/11/03/myrvete-bajrami/>

Dylberizm, 2. (2023, Qershor 22). Pionerët e çlirimit queer: Rrëfimet e Qerkicës dhe Mustafës. Retrieved from

Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2023/06/22/q-m/>

Dylberizm, 2. (2023, Korrik 30). Rrëfimet e Igballe Rogovës përballë patriarkatit, homofobisë dhe nacionalizmit. Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2023/07/30/igo/>

Dylberizm, 2. (2024, Prill 27). Lufta me botën përmes poezisë dhe gazetarisë: Arbër Selmani rreth pranimet të identitetit të tij. Retrieved from Dylberizm: https://www.dylberizm.com/2024/04/27/kr_as/

Dylberizm, 2. (2024, Nëntor 20). Me izolim e frikë: Qysh osht' mu përballë me disfori gjinore n'Kosovë? Retrieved from Dylberizm: https://www.dylberizm.com/2024/11/20/trans_w_7/

Dylberizm, 2. (2024, Nëntor 16). Osht' ndjenjë që kurrë nuk munësh me e largu. Retrieved from Dylberizm: https://www.dylberizm.com/2024/11/16/nst_116/

Dylberizm, 2. (2024, Shkurt 19). Prej identitetit të shtypur në çlirim artistik: Arti dhe aktivizmi queer i Arlinda Morinës. Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2024/02/19/like/>

Dylberizm, 2. (2025, Nëntor 19). "As ni sen ma pak nuk e pranojmë". Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2025/11/19/historia-e-blert-morina/>

Dylberizm, 2. (2025, Dhjetor 14). Munohu me gjetë diçka ma t'dobishme. Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2024/12/14/nst117/>

Dylberizm, 2. (2025, Janar 18). Vendosa me i shkru se nuk mujsha mo. Retrieved from Dylberizm: https://www.dylberizm.com/2025/01/18/nst_118/

Fairclough, N. (1995). Media Discourse. Edward Arnold.

Foucault, M. (1978). The History of Sexuality, Volume I: An Introduction. Pantheon Books.

Goffman, E. (1959). The presentation of self in everyday life. Doubleday.

Goffman, E. (1963). Stigma: Notes on the Management of Spoiled Identity. Prentice-Hall.

Goffman, E. (1963). Stigma: Notes on the management of spoiled identity. Prentice-Hall.

Goffman, E. (1963). Stigma: Notes on the Management of Spoiled Identity. Prentice Hall.

Gross, L. (2001). Up from invisibility: Lesbians, gay men, and the media in America. Columbia University Press.

Hall, S. (1997). Representation: Cultural Representations and Signifying Practices. . Sage.

Herek, G. (2000). Sexual stigma and sexual prejudice in the United States: A conceptual framework. Contemporary perspectives on lesbian, gay, and bisexual identities, 65-111.

Ingraham, C. (1994). Thinking straight, acting bent: Heteronormativity and homosexuality. In S. Seidman, The social construction of sexuality (pp. 307-328). W. W. Norton & Company.

- JB. (2025, Korrik 18). T'du qashtu qysh je, si femër, si mashkull, ti je fmija jem. Retrieved from Dylberizm: <https://www.dylberizm.com/2025/07/18/nst121/>
- Meyer, I. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: Conceptual issues and research evidence. *Psychological Bulletin*, 674-697.
- Mustafa, L. (2021, Maj 23). 8a8 me Adelinën, i ftuar Lendi Mustafa, aktivist i të drejtave të LGBTIQ. (A. Ismaili, Interviewer)
- Mustafa, L. (2025, Nëntor 5). Rikthehet Lendi, transgjinatorit që i ndryshoi jeta me ndërrimin e gjinisë. (B. Zeqiri, Interviewer)
- Plummer, K. (1995). *Telling sexual stories: Power, change and social worlds*. Routledge.
- Rrumbullaku, O. (2019). *Studimi për rininë- Kosovë 2018/2019*. Friedrich-Ebert_Stiftung Kosovo.
- Rubin, G. (1984). Thinking sex: Notes for a radical theory of the politics of sexuality. In C. Vance, *Pleasure and danger: Exploring female sexuality* (pp. 267-319). Routledge & Kegan Paul.
- Ryan, C., Huebner, D., Diaz, R., & Sanchez, J. (2009). Family rejection as a predictor of negative health outcomes in White and Latino lesbian, gay, and bisexual young adults. *Pediatrics*, 346-352.
- Scott, J. (1986). Gender: A useful category of historical analysis. *The American Historical Review*, 1053-1075.
- Sedgwick, E. (1990). *Epistemology of the closet*. University of California Press.
- Warner, M. (1993). *Michael Warner- Fear of a Queer Planet: Queer Politics and Social Theory* (1993). University of Minnesota Press.
- Cass, V. C. (1979). Homosexual identity formation: A theoretical model. *Journal of Homosexuality*, 4(3), 219-235.
- Foucault, M. (1978). *The History of Sexuality, Volume I: An Introduction*. Pantheon Books.
- Goffman, E. (1963). *Stigma: Notes on the Management of Spoiled Identity*. Prentice-Hall.
- Hall, S. (1997). *Representation: Cultural Representations and Signifying Practices*. Sage.
- Van Dijk, T. A. (1993). *Elite Discourse and Racism*. Sage.
- American Psychological Association. (n.d.). Understanding sexual orientation and homosexuality. <https://www.apa.org/topics/lgbtq/orientation>
- Jacobs, L., & Meeusen, C. (2021). Coming Out of the Closet, Also on the News? A Longitudinal Content Analysis of Patterns in Visibility, Tone and Framing of LGBTs on Television News (1986-2017). *Journal of Homosexuality*, 68(13), 2144-2168.
- Sauntson, H. (2016). Coming out. In *The Wiley Blackwell Encyclopedia of Gender and Sexuality Studies*.

